



PARIME NË KUPTIMIN E SIRËS

SALIH ALU SHEJH

**Parime në
kuptimin e
*Sirës***

[Biografisë së
pejgamberit]

Salih Alu esh-Shejh

[Ministër i Çështjeve islamike në
Arabinë Saudite]

Përmbajtja

Hyrje	4
« Me siguri, në të dërguarin e Allahut ka një shembull të shkëlqyeshëm për këdo që shpreson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, si dhe për atë që e kujton Allahun shpesh » [el-Ahzab, 21]	4
1. Ligjëratë e mbajtur rreth vitit 2002.....	5
« Me siguri, në të dërguarin e Allahut ka një shembull të shkëlqyeshëm ... » [el- Ahzab, 21]	6
« [I gjithë] Nderi i takon Allahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve ... » [el- Munafikun, 8].....	8
« Mbahu fort [O Muhamed] për atë që të është shpallur. Vërtet, ti je në shteg të drejtë » [ez-Zuhruf, 43].....	8
« Vërtet, ky është kujtim për ty dhe për njerëzit tu, dhe ju do të merreni në pyetje » [ez-Zuhruf, 44]	8
« Ne do ta kthejmë atë në gjendjen e mëparshme » [Ta-Ha, 21]	10
- Shkolla e parë e të kuptuarit	19
- Shkolla e dytë e të kuptuarit	21
« Vërtet, ky [Kur'an] është kujtim për ty dhe për popullin tënd ... » [ez-Zuhruf, 44]	22
- Shkolla e tretë e të kuptuarit.....	23
- Shkolla e katërt e të kuptuarit	24
- Shkolla e pestë e të kuptuarit.....	25
« Shmanguni prej tij [alkoolit], me qëllim që të jeni të	

suksesshëm » [el-Ma'ideh, 90].....	33
« Lidhja e gjakut [farefisi] është më e afërt [sa i përket trashëgimisë] në vendimin e caktuar nga Allahu » [el-Enfal, 75]	35
« Thuaj: 'Kjo është rruga ime. Ju thërras për te Allahu me urtësi, unë dhe ata që më ndjekin. I lartësuar është Allahu! Dhe unë nuk jam nga ata që i shoqërojnë ortakë Atij [në adhurim]' » [Jusuf, 108]	39
« Vërtet, në rrëfenjat e tyre ka mësim për njerëzit që kuptojnë. Ky [Kur'ani] s'është thënie e falsifikuar ... » [Jusuf, 111]	39
- Pyetje-përgjigje	42

Hyrje

Lavdi Allahut ashtu siç e meriton të lavdërohet, dhe i gjithë falënderimi i takon Atij, të madhërishmit, më të lartit. Nga bekimet e mëdha të Tij ndaj nesh është dërgimi i Muhamedit [salallahu alejhi ue selam] tek ne si një udhëzim, përgëzim e paralajmërim.

« Ne nuk të dërguam veçse si mëshirë për botët » [el-Enbija, 107]

« Me siguri, në të dërguarin e Allahut ka një shembull të shkëlqyeshëm për këdo që shpreson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, si dhe për atë që e kujton Allahun shpesh » [el-Ahzab, 21]

Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet, përveç Allahut, i cili është i pashoq, dhe dëshmoj se Muhamedi [salallahu alejhi ue selam] është rob, i dërguar e mik i Tij. Me të [salallahu alejhi ue selam], Allahu i dha fund shirkut dhe ushtrive të tij, dhe vendosi teuhidin dhe ithtarët e tij. Dhe me të [salallahu alejhi ue selam], Allahu u dha shikim njerëzve, pasi ishin të verbëruar [dmth të paditur rreth fesë], dhe i udhëzoi njerëzit pasi ishin në drejtim të gabuar.

Pra, çfarë e mire mund të jetë më e madhe sesa dërgimi i Muhamedit [salallahu alejhi ue selam]? Dhe çfarë e mire mund të jetë më e madhe sesa e mira e Muhamedit ndaj umetit të tij? Edhe sikur ta lironin me pagesë veten e tyre, familjet e tyre dhe pasurinë e tyre, ata ende nuk do

të kompensonin për detyrën e Muhamedit [salallahu alejhi ue selam]. A nuk na gjeti ai në shtegun që çon në zjarr dhe na largoi nga ai.

1. Ligjëratë e mbajtur rreth vitit 2002.

Selamet qofshin mbi pejgamberin Muhamed, ngaqë udhëzoi, mësoi e qartësoi. Dëshmojmë se ai barti plotësisht porosinë dhe e kreu detyrën, si dhe këshilloi umetin dhe u mundua në rrugën e Allahut me një përpjekje të drejtë. Ai na la në një shteg të qartë dhe të pastër, nata e të cilës është si dita e saj, dhe askush nuk shmanget prej këtij shtegu pas tij, përveçse ai person shkatërrohet. Lutjet dhe paqja qofshin mbi shoqëruesit [sahabët] e tij, të cilët e ndihmuan dhe e nderuan atë. Dhe lutjet e paqja qofshin mbi të gjithë ata që i ndjekin ata në të mirë, deri në Ditën e Shpërblimit.

Në vazhdim:

E lus Allahun të më bëjë mua dhe juve nga ata që i binden Atij, përzemërsisht të përqendruar, dhe nga ata të cilëve u pranohen lutjet. O Allah, na bëj nga ata që kanë zemra të frikësuar nga Ti dhe zemrat e të cilëve zbuten, kur të kujtojnë Ty. O Allah, na udhëzo, meqë s'ka lëvizje e as mundësi, përveç nëpërmjet Teje. Kërkojmë shpëtim te Ti nga veprimi kryelartë në tokë dhe nga bërja e trazirave në të, dhe të lusim të na ndihmosh nga ligështimet dhe nga opinionet e gabuara. O Allah, na jep sukses, se Ti je Pronar i suksesit. Dhe kushdo që udhëzon, është i udhëzuar.

Në fillim të kësaj ligjërate, do të doja të falënderoja vëllezërit bujarë të *Mektebeh Da'ueh ue'l-Irshad* në el-Kherxh që më ftuan të jem i pranishëm në këtë ligjëratë dhe u përkujdesën rreth saj. Kjo s'është aspak e habitshme, meqë ata përkujdesen për çdo gjë të mirë. Allahu ua shtoftë mirësinë dhe e pranoftë punën e tyre në përhapjen e së vërtetës dhe udhëzimit!

Tema e kësaj ligjërate ka të bëjë me parimet për kuptimin e Sirës [biografisë] së Mustafasë [salallahu alejhi ue selam]. Kjo ligjëratë nuk është një këshillë, por një ligjëratë fundamentale lidhur me çështjen e Sirës së pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Ndaj, mund të ndodhë që të gjithë të përfitojnë nga kjo, posaçërisht ata që merren me dije, me Sunetin dhe me Sirën, si dhe me dauet e me udhëzim.

S'ka dyshim që biografia e el-Mustafasë [salallahu alejhi ue selam] është diçka që dijetarët e kaluar dhe të tashmit i kanë kushtuar rëndësi. Kjo, sepse udhëzimi i el-Mustafasë i qartëson gjërat, siç ka thënë Allahu:

« Me siguri, në të dërguarin e Allahut ka një shembull të shkëlqyeshëm ... » [el- Ahzab, 21]

Kështu, rëndësia e biografisë është thelbësore, sepse biografia dhe preokupimi me të është dije rreth pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], nga lindja e tij deri në vdekje. Me Sirë, muslimani e di në çka kanë qenë pejgamberi dhe sahabët e tij në përhapjen e fesë dhe përpjekjet e tyre, të cilët kanë lënë një shteg të qartë pas

tyre. Islami nuk u përhap lehtësisht, por pejgamberi u përpoq me ndihmë nga Zoti i tij, i madhërishmi, më i larti, dhe, po ashtu, nëpërmjet përpjekjeve të sahabëve bujarë, çka është evidente në Sirë.

Gjithashtu, nga rëndësia e njohjes së Sirës së el-Mustafasë [salallahu alejhi ue selam] dhe të sahabëve është se kjo vendos në zemrat e njerëzve një iman të madh dhe një bindje të fortë, pavarësisht çka u ka ndodhur atyre dhe pavarësisht asaj çka Shejtani dhe ushtritë e tij janë përpjekur të bëjnë. Sepse në të dërguarin e Allahut ata kanë një shembull të shkëlqyer dhe, po ashtu, në sahabët.

Një ditë prej ditësh, disa nga sahabët u ankuan te pejgamberi [salallahu alejhi ue selam], kur u përballën me presionin e Kurejshitëve ndaj tyre, dhe ai iu tha:

"Para jush, qe një njeri i cili u nda në dysh me sharrë, duke u pre mishi dhe eshtrat e tij, dhe, megjithëkëtë, nuk hoqi dorë nga besimi i vet. Pasha Atë, në Dorën e të cilit është shpirti im, kjo çështje [feja] do të plotësohet, derisa një udhëtar të udhëtojë nga Meka në Sanaa' [në një transmetim tjetër: nga Basra në Mekë] duke mos pasur frikë nga ndonjë gjë, përveç nga Allahu".

Kjo e qartëson faktin se e vërteta nuk është e tillë, për shkak të numrit të madh të njerëzve, dhe besimtari, nëse i ndodh diçka nga komplotet e Shejtanit apo nga joshjet e dëshirat e mëdha, duhet të tregohet më këmbëngulës në fenë e Allahut, ashtu siç sahabët nuk e lanë fenë e tyre

dhe nuk pushuan së ndari nga shirku, dhe nuk e lanë atë në çka besonin, për shkak të asaj që i godiste – mbi ta qoftë kënaqësia e Allahut. Pra, si është puna e disa njerëzve sot, të cilët, ndoshta, i lënë disa gjëra të fesë, për shkak të joshjeve?

Kur muslimani lexon Sirën, e përforcon bindjen dhe përgatitet e forcohet në fenë e Allahut. Për këtë shkak, zemra e besimtarit arrin nder në Islam, duke u nderuar me teuhidin e Allahut dhe me imanin në Muhamedin [salallahu alejhi ue selam] dhe në atë që Allahu i ka shpallur të dërguarit të Tij:

« [I gjithë] Nderi i takon Allahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve ... » [el- Munafikun, 8]

Pra, këtë mund ta përfitojë çdo musliman që këqyr Sirën e el-Mustafasë [salallahu alejhi ue selam]. Parimi bazë në këtë është se Sira nuk duhet të krahasohet me leximin e rrëfenjave dhe tregimeve, por me leximin e saj duhet të reflektojmë dhe të nxjerrim mësim. Sepse leximi i Sirës ofron shembuj udhëzimi e mirësie, si edhe shembuj të kapjes për të vërtetën.

« Mbahu fort [O Muhamed] për atë që të është shpallur. Vërtet, ti je në shteg të drejtë » [ez-Zuhruf, 43]

« Vërtet, ky është kujtim për ty dhe për njerëzit tu, dhe ju do të merreni në pyetje » [ez-Zuhruf, 44]

Dijetarët i kanë klasifikuar synimet e Sirës dhe rëndësinë e preokupimit me të. Synimi i Sirës është ajo që është transmetuar rreth pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], rreth sahabëve e tabi'inëve [pasuesve të sahabëve], si dhe rreth atyre që erdhën pas tyre nga dijetarët në përshkrimin e rrethanave të jetës dhe shtegut të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], prej lindjes së tij deri në kalimin e tij tek Allahu i lartësuar.

Brenda saj ka gjëra që kanë ndodhur gjatë lindjes së tij dhe përmendje të ngjarjeve të mrekullueshme, të cilat zunë vend në atë kohë. Po ashtu, aty ka një shfaqje të disa ngjarjeve në fillim të pejgamberllëkut të tij. Përmendet edhe edukimi i tij, nëna e tij si dhe kthesa në ngjarjet që ndodhën më pas, prej kur ai ishte i ri derisa Allahu e dërgoi [si pejgamber].

Kështu, Sira përfshin gjëra rreth karakterit dhe reputacionit të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] para daljes së tij [si pejgamber]. Biografia e pejgamberit është një përshkrim i jetës së tij nga momenti kur u dërgua si një pejgamber dhe mbarti dauetin e Allahut me durim deri në migrimin e tij në Medinë, vendosjen e shtetit të parë islamik dhe kalimin e tij tek Allahu, më i larti.

Shumë dijetarë, në Sirë përfshijnë edhe periudhën e halifeve të drejtë dhe pushtimet e tyre. Ndaj, biografia paraqet një rrugë paraprakisht të trasuar. *Sare*: të përshkosh një rrugë; të nisesh për rrugë. *Jesiru sejrān*: model i sjelljes; mënyra e jetës, të cilën ai e ndoqi, dmth

rruga që peygamberi përshkoi.

Kur'ani përmend Sirën me domethënien e mënyrës së një gjendjeje:

« **Ne do ta kthejmë atë në gjendjen e mëparshme** » [Ta-Ha, 21]

Kështu, Sira përfshin rrugën që është ndjekur dhe gjendet në të cilat është përshkruar rruga. Për këtë shkak, Sira kombinon rrugën që është ndjekur dhe, krahas kësaj, *meghazi* [ekspeditat ushtarake] dhe pushtimet si dhe çfarë i ndodhi peygamberit dhe sahabëve pas tij gjatë atyre ekspeditave.

Sira, siç e përmenda, ka një domethënie gjuhësore dhe një domethënie teknike. Dijetarët kanë vërejtur se ajo që është synuar me Sirë, është ajo që është shënuar në libra të posaçëm, të cilat u emërtuan si libra të Sirës. Dijetarët kanë përmendur se Abban ibn Uthman ibn Affan, biri i halifes së udhëzuar drejt, që i pari i cili vendosi një Sirë të shkruar të el-Mustafasë dhe të ndeshjeve luftarake. Abban vdiq më 105H. Ai kishte marrë prej shumë sahabëve dhe, sipas radhës, shumë nga ata që pasuan, morën prej tij.

Nga ata që janë të njohur për sigurimin e informatave rreth Sirës, është Urweh ibn Zubejr ibn el-Auam, i cili qe një Imam i literaturës së ekspeditave ushtarake. Ai ka një shënim të tijin rreth ekspeditave ushtarake, të cilën e emëroi *Meghazi Urweh*. Pra, ai e përmbledhi dhe e

publikoi atë.

Po ashtu, nga ata që i kushtuan rëndësi Sirës, qe edhe Ibn Shihab ez-Zuhri, Imami i mirënjohur dhe muhadithi i kohës së vet. Ai përmbloodhi një libër rreth Sirës dhe një libër rreth ekspeditave ushtarake nga ajo çfarë Umer ibn AbdulAziz [rahimehullah] ia kishte përmendur atij.

Gjithashtu, nga ata që kontribuan në Sirë nga dijetarët e tjerë, është Asim ibn Umer ibn Katadeh dhe të tjerë veç tij nga dijetarët e besueshëm nga shekulli i parë [pas hixhretit] dhe fillimi i shekullit të dytë. Me këtë, shohim se të shkruarit e biografisë [Sirës], me të vërtetë, ishte mjaft e zhvilluar dhe, për këtë shkak, dijetarët, pas kësaj periudhe, morën nga ata që erdhën më pas traditën e interesimit rreth Sirës dhe ekspeditave ushtarake, dhe kombinuan atë çfarë dëgjuan nga disa prej tyre.

Dijetari i mirënjohur Muhamed ibn Is'hak el-Medeni e kombinoi biografinë në këtë mënyrë në librin e tij *es-Sir ue'l-Meghazij*. Po ashtu, thuhet se ai qe udhëzuar të vepronte

kësisoj nga Ebi Xha'fer el-Mensur. Kur Ibn Is'hak e vizitoi Bagdadin, Ebi Xha'fer e udhëzoi atë për te biri i tij, i cili i tha Ibn Is'hakut: "A e njeh këtë njeri?", në çka Ibn Is'hak u përgjigj: "Po. Ky është i biri i udhëheqësit të besimtarëve". Më pas, Ebi Xhafer i tha Ibn Is'hakut: "Mblidh një libër për të ku do të përmenden të dhënat nga krijimi i Ademit deri më sot". Ibn Is'hak e bëri këtë dhe ky libër i tij përcillet nga ai dhe është përhapur mjaft pas tij. Ai është Imam i Sirës të cilën e përmbloodhi me duart e tij

dhe e shpërndau, dhe e cila bazohej në informata nga ata që erdhën para tij nga paraardhësit besnikë.

Nëse puna qëndron kështu, atëherë shkrimet e Ibn Is'hak, në të vërtetë, sot nuk ekzistojnë në formën e plotë. Këto, në fakt, gjinden vetëm përbrenda punimeve dhe verifikimeve të Ibn Hisham, dijetarit të mirënjohur të gjuhës arabe. Rreth saktësisë së verifikimeve të Ibn Hisham ka pajtim mes dijetarëve, dhe ajo bazohet në Sirën e Ibn Is'hak dhe në çfarë ai transmetoi dhe punoi. Mirëpo, ajo s'është transmetuar drejtpërdrejt nga Ibn Is'hak, por nga njëri prej transmetuesve të besueshëm, i cili ka transmetuar nga Ibn Is'hak. Kjo Sirë është e njohur sot si Sira e Ibn Hisham.

Mes dijetarëve nisi të zhvillohej punimi i Sirës. Ibn Hazm shkroi një biografi të titulluar *Xheuami es-Sirëh*. Ibn Sejjid en-Nas, po ashtu, shkroi një biografi dhe dijetarët vazhduan të shkruanin biografi, ndonëse me e besueshmja e këtyre që u përmendën është ajo e Ibn Hisham nga Ibn Is'hak, sepse ata përmendën punime të tjera rreth ekspeditave ushtarake.

Gjithashtu, ndër ata që i dhanë rëndësi punimeve të Sirës përfshihet edhe el-Uakidij. Disa dijetarë e kanë lavdëruar për punimet rreth ekspeditave ushtarake, por disa dijetarë të tjerë thonë se "punimet e tij rreth ekspeditave duhet të konsiderohen si ato të haditheve – hadithet e tij nuk janë të pranueshme". Punimet rreth ekspeditave të el- Uakidit sot nuk ekzistojnë dhe shumë dijetarë mbështeten në këtë. Është e saktë se *el- Uakidijeh* nuk

është verifikuar plotësisht në atë çfarë është transmetuar, dhe, ndoshta, mund të jetë se ai ka marrë transmetime që nuk njihen nga dijetarët. Ndaj, hadithet e tij që kanë të bëjnë me ekspeditat dhe që janë refuzuar nga dijetarët, nuk janë të pranueshme, posaçërisht ajo që ndryshon nga bazat apo bie në kundërshtim me të folmen e dijetarëve rreth Sirës.

Po ashtu, ndër ata që punuan Sirë është edhe Ibn Sa'd, autori i *et-Tebeekat*, që është e mirënjohur. Këto janë nga ato që njihen si punime dhe libra rreth biografisë, të cilave dijetarët u kanë kushtuar vëmendje që nga e kaluara deri më sot.

Po ashtu, ka shkrime rreth Sirës që ndjekin një metodë tjetër, dhe kjo është metoda e njerëzve të hadithit. Ata janë preokupuar me Sirën e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] dhe përmendjen e gjendjeve/kushteve të tij, përplasjeve ushtarake dhe gjërave të ngjashme bazuar në atë çfarë përmendet në librat e hadithit. Kështu, në *Sahi* të el- Buharit, gjen kaptinën e ekspeditave ushtarake. Po ashtu, Imam Muslim ka një biografi të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Njëlloj, këtë e gjen edhe tek Ebu Daud.

Njerëzit e hadithit i kanë dhënë rëndësi klasifikimit dhe kanë përmendur zinxhirët e transmetimit, të cilat kanë të bëjnë me Sirën, duke përmendur atë që është e vërtetë dhe atë që nuk është e pranueshme, siç ka shkruar edhe el-Hafidh Zejnudin el- Irakij: "Studenti duhet të dijë se Sira përbëhet nga ajo që është e vërtetë dhe nga ajo që

nuk pranohet".

El-Bejheki ka klasifikuar librin *Dela'il en-Nubeueh*, dhe po ashtu dhe Ebu Nuejm el- Isfahani apo el-Isbahani dhe Ahmed ibn Abdilah, një dijetari i mirënjohur. Kështu, dijetarët e hadithit u morën me punimet e Sirës nga dy këndvështrime:

Në klasifikimin e asaj që është e vërtetë dhe zinxhirëve të transmetimit që përmendin Sirën, gjë që ose është përgatitur sistematikisht, ose ndryshe.

Ajo çka ata posaçërisht kanë përcaktuar nga punimet që janë shkurtuar, të cilat përmendin dëshmitë e pejgamberllëkut [*Dela'il en-Nubuweh*].

Siç kemi përmendur, librat e Sirës nuk preokupohen me vërtetësinë, por ato përmendin atë që është transmetuar në Sirë. Për këtë shkak, el-Hafidh Zejnudin el-Irakij ka thënë: "Studenti duhet të di se Sira përbëhet nga ajo që është e vërtetë dhe nga ajo që nuk pranohet". Pra, brenda saj gjinden gjëra të vërtetuara si dhe ajo që s'është pranuar dhe është refuzuar. Kjo është e qartë, sepse Sira e Ibn Is'hak, për shembull, përfshin shumë nga ajo që është vërtetuar dhe shumë nga ajo që s'është pranuar. Dhe kjo është e mirënjohur në çështjet e Sirës. Pra, nëse kështu qëndron puna, atëherë ajo që është me vend në verifikimin e pozitës së Sirës është verifikimi i burimeve të Sirës dhe nxjerrja e Sirës sipas parimeve të rëndësishme, çka përbën një pyetje dhe një përgjigje: "Si të nxjerrim Sirën në mënyrë të sigurt?" Përgjigja është se

Sira e el-Mustafasë [salallahu alejhi ue selam] fillimisht duhet të merret nga Kur'ani, meqë Kur'ani përmend jetën e tij prej kur ishte i ri:

« **A nuk të gjeti jetim dhe të strehoi** » [ed-Duha, 6]

Ai, më i larti, përmend gjendjen e tij [salallahu alejhi ue selam] para se të caktohej si pejgamber. Përmendet misionin e tij pejgamberik dhe vizitën nga xhinët, kur ata dëgjuan Kur'anin. Përmendet gjendja e tij me idhujtarët dhe daueti i tij ndaj tyre.

Përmendet ngjarja e hixhretit. Dhe përmenden përplasjet ushtarake, si beteja e Bedrit në suren el-Enfal, beteja e Uhudit në suren Aal-Imran, beteja e Hendekut dhe e aleancës së klaneve në suren el-Ahzab, pushtimi i Mekës dhe Marrëveshja e Hudejbijes në suren el- Fet'h, beteja e Hunejnit dhe ajo e Tebukut në suren el-Bekare dhe të tjera veç këtyre.

Kështu, nëse një nxënës dijeje kombinon atë çfarë kanë diskutuar komentuesit nga sahabët dhe ata pas tyre lidhur me këto ajete, do të ketë një burim të fortë e të besueshëm nga Kur'ani. Një grup dijetarësh kanë punuar fort në këtë drejtim, por ata nuk kanë mbledhur – me sa di unë – një përmbledhje të plotë sipas asaj çka kanë përmendur komentuesit e Kur'anit. Disa nga dijetarët bashkëkohorë janë përpjekur për këtë dhe kanë dhënë mundin në këtë drejtim, ndonëse nuk kanë sistemuar të gjitha komentet e dijetarëve verifikues nga komentuesit e Kur'anit rreth ajeteve të rëndësishme. Ndaj, është e

domosdoshme që, sa i përket Sirës, të mbështetemi në atë çfarë përmend Kur'ani lidhur me të dhe në çfarë kanë shënuar komentuesit e Kur'anit rreth ajeteve që kanë të bëjnë me Sirën e el-Mustafasë [salallahu alejhi ue selam].

Burimi i dytë për Sirë është hadithi i vërtetë, posaçërisht ato që gjenden në dy Sahitë [Buhari & Muslim] apo ajo që është vërtetuar në të tjera koleksione të hadithit, që përmendin hadithe rreth Sirës së pejgamberit. Nëse këto hadithe kombinohen me atë që përmendet në librat e Sirës, gjejmë se diçka që është transmetuar në librat e Sirës, s'është e vërtetuar. Për shembull, një pjesë nga ajo që ka të bëjë me disa nga betejat, gjendjet, dhe disa gjëra nga *Israja* dhe *Miraxhi*.

Burimi i dytë i besueshëm, pas Librit të Allahut dhe shpjegimit të tij, janë hadithet që nuk janë përmendur në Librin e Allahut, më të lartit, dhe në atë në çka u mbështetën sahabët dhe pasuesit e tyre në shpjegimin e ajeteve të Kur'anit sipas metodologjisë së selefëve në tefsir të Kur'anit me Sunet. Ndaj, mbështetja në atë që është brenda librave autentikë dhe librave të hadithit si burime të Sirës është parësore dhe më larg hutimit dhe të pavërtetave brenda Sirës.

Për këtë shkak, shumë nga dijetarët kanë bërë thirrje për bërjen e biografive autentike pejgamberike. Disa nga bashkëkohësit janë orvatur ta bëjnë këtë dhe kanë hasur në një kodër të madhe problemesh, meqë kjo çështje kërkon njohuri në fushën e hadithit dhe në zinxhirët e transmetimit, si edhe njohuri rreth tefsirit, gjuhës, librave

të Sunetit, librave të akides dhe të tjera veç këtyre nga ajo që është lënë pas dore nga ata që punuan Sirë më herët.

Po ashtu, nga burimet [e Sirës] që janë të besueshme, janë librat e Sirës që përmendëm dhe librat historike. Gjejmë, për shembull, se historia e Ibn Xheririt transmeton shumë nga Sira e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] me zinxhirët e transmetimit. Mirëpo, kjo është marrë nga ajo që s'është Kur'an dhe nga shpjegimi i tij, si dhe nga ajo që s'është verifikuar në Sunetin e el-Mustafasë [salallahu alejhi ue selam].

Kështu, nëse nuk gjejmë ndonjë ngjarje në Libër [Kur'an] apo në Sunet, atëherë mund të merrim nga librat e Sirës dhe s'ka problem në këtë, meqë kjo [rrëfenjat nga Beni Israilët] është e një vlere të lartë sipas pajtimit të dijetarëve. Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] na ka thënë: "Rrëfeni nga Beni Israilët. S'ka të keqe në këtë".

Pra, nëse gjendet në librat e Sirës dhe nuk bie në kundërshtim me Librin dhe me Sunetin, s'ka problem të përdoret kjo dhe të mbështetemi në të, dhe dijetarët kanë vepruar kështoj. Kështu, shohim që Ibn Kethir [rahimehullah] në fillimin e librit të tij *el-Bidajeh ue'n-Nihaje* shkroi një Sirë të gjatë të pejgamberit, që përbën katër vëllime, dhe aty ka kombinuar atë që është përmendur nga njerëzit e Sirës dhe atë që është përmendur nga dijetarët e hadithit, si dhe atë që ka ardhur në ajetet Kur'anore. Ndonëse kjo kërkon një inspektim të shtuar.

Pra, ka burime të përgjithshme të Sirës dhe, kur kjo të qartësohet, ajo që mund të vërehet është se dijetarët e hadithit, ithtarët e etherit [transmetimeve nga selefët] që identifikohen me selefët e këtij umeti, janë ata që i kushtojnë rëndësi Sirës së el- Mustafasë [salallahu alejhi ue selam]. Disa njerëz thonë: "Ata që preokupohen me hadithe dhe me transmetime tjera, dhe të cilët identifikohen me metodën rrugën e selefëve, nuk kanë ndonjë interesim për Sirën!" Kjo s'është e vërtetë. Madje, ata që interesohen për Sirën e el-Mustafasë nga pikëpamja e verifikimit, seleksionimit, e të kuptuarit dhe dëshmisë, janë pasuesit e selefëve të këtij umeti.

Nëse ai që kapet për hadithin dhe për transmetimet përballet me ndonjë vështirësi, atëherë kjo kërkon ilaç, sepse në Sirën ka dobi fusha dhe të ndryshme shkence, të cilat një person, një besimtar a një nxënës dijeje mund t'i mësojë, dhe të cilat s'mund të arrihen, përveç me leximin e Sirës. Kjo, po ashtu, vendos krenari në zemër për fenë e Allahut si edhe lumturi për fitoret e fesë gjatë periudhës së parë, gjë që bën të lindë dashuria ndaj pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] dhe ndaj shoqëruesve të tij, duke u shtuar kështu udhëzimi për besimtarin.

Gjejmë që Imamët e këtij daueti i kushtuan rëndësi Sirës, si Imami dhe *muxhedidi* shejhul-Islam Muhamed ibn AbdulUehab [rahimehullah], i cili punoi një libër mbi Sirën e Mustafasë [salallahu alejhi ue selam] që është botuar dhe në dispozicion. Gjithashtu, i biri i tij, Imami, shejh Abdullah ibn Muhamed ibn AbdulUehab, ka një libër mbi Sirën e el-Mustafasë. Në biografitë e tyre, ata

përmendin një sërë dobish që nxirren nga Sira, posaçërisht dobitë lidhur me dauetin. Një përmendje e dobive lidhur me dauetin nga Sira e Mustafasë [salallahu alejhi ue selam] do të vijojë më vonë.

Ndaj, angazhimi në Sirë është verifikim, kuptim i saj dhe deduktim, dhe është ajo në çka kanë qenë dijetarët tanë. Kushtimi i rëndësisë ndaj Sirës është cilësi e nxënësit të dijes, nxënësit serioz, dhe është cilësi e atyre që në përgjithësi e duan të mirën. Ajo zbut zemrat e njerëzve, vendos ambicie në shpirtrat e tyre dhe i nderon ato. Ndër këto është përmendja e tregimeve nga Sira dhe ngjarjet e vendimet që ndodhën në to.

Pikëpamjet e njerëzve dhe autorëve, si dhe të atyre që studiojnë Sirën, janë të ndryshme. Është me vend që ky shqyrtim të emërohet "Shkollat e mendimit në të kuptuarit e Sirës së pejgamberit, lutjet dhe paqja qofshin mbi të". Meqë Sira e Mustafasë ka shkolla të ndryshme të mendimit, të cilat përpiqen ta kuptojnë atë, të shkruajnë rreth saj dhe të hulumtojnë rëndësinë e saj. Nga këto shkolla të mendimit, të cilat angazhohen në kuptimin e Sirës, është:

- Shkolla e parë e të kuptuarit

Shkolla e parë e të kuptuarit është shkolla gjuhësore e të kuptuarit. Ithtarët e kësaj shkolle e kuptojnë Sirën duke i kushtuar rëndësi gjuhës së saktë. Meqë, kushdo që ka transmetuar Sirën - siç janë tabi'inët si Ibn Is'hak -, e ka transmetuar me gjuhë të saktë. Dhe ajo që është e

pranishme sot në Sirë nga informatat, kallëzimet, ligjëratat e mbajtura arabëve, rrëfenjat, ligjëratat e mbajtura sahabëve, dhe thëniet rreth këtyre, e gjithë kjo është nga pikëpamja e gjuhës dhe është e besueshme.

Kështu, për këtë shkak, Ibn Hisham i kushtoi rëndësi Sirës së Ibn Is'hakut. Ai [Ibn Hisham] qe një gjuhëtar arab, që e njihnte mjaft mirë arabishten. Ai i kushtoi rëndësi asaj çfarë kishte përmendur Ibn Is'hak në Sirën e tij dhe, më pas, e përmendi këtë në versionin e shkurtuar të Sirës së vet "Sira e Ibn Hisham". Në të, ai përmendi atë që është në pajtim me të si dhe atë që nuk duhet marrë, gjë që edhe e la jashtë saj. Krahës kësaj, ai publikoi edhe një shpjegim të ndonjë çështjeje të çuditshme, e cila ka ngjallur interesim. Njëllor, edhe Sira e Ibn Hisham është kuptuar nga ata dijetarë, të cilët janë përqendruar në vlerësimin e Sirës nëpërmjet vlerësimit të gjuhës, me anë të shpjegimit të gjuhësor, dhe baza e qëllimit të tyre është vlera gjuhësore. Ndër ta është el-Hafidh es-Suhejli, i cili e ka punuar *er-Reudh el-Unuf*, që ishte një shpjegim i Sirës së Ibn Hisham. Pastaj el-Hafidh Ebi Dherr el-Khushanij me shpjegimin e tij *Ghariib es-Sirëh*. Të dyja këto punime janë botuar dhe publikuar. Punimi i el-Hafidh es-Suhejlit është voluminoz, kurse ai i Ebi Dherr el-Khushenit ka vetëm një vëllim.

Më këtë lloj interesimi, do të gjeni se shumë nga ata që e çmojnë literaturën dhe gjuhën, janë të interesuar në Sirën, kështu që është e dosmodoshem të bëhet një dallim, kur shikohet në punimet e shkruara të Sirës, duke bërë kategorizimin [dmth shkollave të mendimit] e

punimeve të shkruara. Kështu, nëse dihet se autori është nga kategoria e gjuhëtarëve dhe interesimi kryesor i tij është vlerësimi i gjuhës, atëherë do të keni mundësi të hulumtoni për atë që kërkon nga përmendja e gharib në Sirëh dhe asaj që është e ngjashme me këto çështje. Si i tillë, autori i kushton një interes të veçantë kësaj, ndryshe nga siç veprojnë të tjerët brenda shkencave të Sirës.

Autorët e letërsisë, po ashtu, i kushtojnë rëndësi Sirës, disa prej të cilëve nga vende të ndryshme kanë punuar libra mbi Sirën. Dhe do të gjeni se shumica prej tyre janë shkrimtarë. Trajtimi i Sirës është shprehje e shkrimtarëve, sepse me Sirën bëhet shtimi i literaturës dhe në të ka një prozë madhështore. Shumë nga këta autorë kanë kryer punime lidhur me Sirën dhe kanë transmetuar Sirën sipas metodave të shkrimtarëve. Kjo shkollë e mendimit ka një shpjegim të gjerë të saj, që përmend aspektet pozitive dhe defektet e saj.

- Shkolla e dytë e të kuptuarit

Shkolla e dytë e të kuptuarit të Sirës është shkolla e nacionalistëve arabë. Ata që i kushtojnë rëndësi arabëve dhe kanë partishmëri ndaj arabizmit dhe ndaj "nderit arab", shohin se "të lavdishmit" e pararendësve të tyre, siç pohojnë ata, kanë shkruar biografi për vetveten. Ata, po ashtu, pohojnë se lavdia e arabëve nuk ka nisur veçse me ardhjen e Muhamedit [salallahu alejhi ue selam], dhe me të arabët janë ekzlatuar në kulmin e tyre, siç ka thënë Allahu:

« Vërtet, ky [Kur'an] është kujtim për ty dhe për popullin tënd ... » [ez-Zuhruf, 44]

Pra, me anë të kësaj, janë ndritur arabët. Kështu, ata e kuptuan Sirën dhe punuan lidhur me të nga pikëpamja se të gjithë popujt e civilizuar, si grekët e lashtë, persianët e lashtë, romakët e lashtë, etj., të gjithë kanë biografi të personaliteteve të tyre të mëdha në formën e punimeve letrare, dhe qëllimi i këtyre ka qenë ngritja e nderit të tyre.

Prandaj, shumë nga bashkëkohësit dhe ata nga e kaluara, e kanë kuptuar Sirën si një ngritje të nderit arab dhe një ngritje të arabëve mbi të tjerët. Brenda këtyre ka të tjera shkolla të ndryshme mendimi, si shkolla e Ta-Ha Huseinit dhe e të tjerëve si ky nga ata që kanë shkruar Sirë. Sepse këta kanë shkruar rreth Sirës jo për t'i dhënë fitore fesë së Muhamedit [salallahu alejhi ue selam], por me synimin e ngritjes së popullit arab.

Vërtet, ata janë, siç ka përmend edhe Ta-Ha Husein në parathënien e librit të tij *Ala Hamish is-Sirëh*, ku përmend se "Kjo Sirë ...", - që ai shkroi -, "përfshin gjëra që intelektin dhe shpirti s'mund t'i pranojë. Mirëpo, njerëzit kanë nevojë për besëtytni të tilla në jetët e tyre dhe për hadith, çka e bën më të lehtë pranimin e gjërave nga ana e tyre". Domethënë, ato thjesht janë rrëfenja dhe fabula, të cilat s'kanë as bazë [sipas kuptimit të shtrembër të tij për intelektin] e as rëndësi. Ai përmend në parathënien e librit të tij se ka bërë hulumtime sipas të kuptuarit të vet dhe ka gjetur se grekët dhe persianët e lashtë kanë pasur

personalitete të mëdha, të cilët i kanë përmendur në historitë e tyre, dhe konsideroi se është e nevojshme pasja e një kategorie të tillë të Sirës dhe e punimeve sipas këtij koncepti.

Ndaj, kur shikojmë në punimet e një autori, është e domosdoshme që, po ashtu, të shikohet në kategorinë e shkollës së të kuptuarit të cilës i takon ai. Meqë, nëse njerëzit lexojnë një libër nga një person i cili i takon shkollës nacionaliste të të kuptuarit, ndoshta, ata do të ndikohen nga lloji i defektit në të kuptuarit e Sirës së pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Madje, mund të ndodhë që personi të mos besojë në mrekullitë e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] apo në shenjat dëshmuere të tij, duke i konsideruar ato thjesht si rrëfenja dhe fabula të parëndësishme për "realitetin" apo "situatën aktuale", siç ka thënë ai.

- Shkolla e tretë e të kuptuarit

Shkolla e tretë e të kuptuarit të Sirës është ajo e dijetarëve, juristëve dhe dijetarëve të hadithit, të cilët i kushtojnë rëndësi të madhe Sirës. Kështu, ata kryejnë punime rreth Sirës duke vënë theksin në çështjet e vendimeve, shpjegimeve të çështjeve të akidesë dhe shpjegimeve të vendimeve të fikhut që gjenden brenda Sirës.

Kjo mund të shihet në shembullin e atyre që janë angazhuar në Sirë, si Imamët e hadithit el-Buhari dhe të tjerët pas tij, si el-Hafidh el-Bejheki në *ed-Dela'il un-*

Nubuweh, si edhe ata pas tyre, si Shejh el-Islam ibn Tejmije, meqë e shihte Sirën nga pikëpamja e fikhut, dhe thëniet e tij u shpjeguan dhe u dalluan si qëndrime mbi Sirën nga el-Alame Shemsudin ibn el-Kajjim në librin e tij *Zad el-Me'ad fi Hedji-l'Khajr il-Ibad*. Ai e kuptoi Sirën duke përmendur verifikimet brenda saj dhe përmblodhi një Sirë në dritën e asaj që është përmendur në Kur'an, në Sunet dhe në komentimet e dijetarëve të Sirës, si dhe e shikoi atë nga pikëpamja e fikhut dhe besimit. Ata që e ndoqën atë në zbatimin e kësaj metode qenë Imami dhe *muxhedidi* shejhul-Islam Muhamed ibn AbdulUehab dhe i biri tij Abdullah ibn Muhamed ibn AbdulUehab. Ata kryen punime rreth Sirës nga pikëpamja e dijes islamike dhe kombinuan Sirën, rrëfenjat dhe dijen.

S'ka dyshim që kjo shkollë e të kuptuarit është shkolla më madhështore e të kuptuarit të Sirës dhe më e dobishmja, siç do të sqarohet, inshaAllah.

- Shkolla e katërt e të kuptuarit

Shkolla e katërt e të kuptuarit është shkolla e mendimit modernist. Modernistët nga thirrësit [në Islam], sipas pikëpamjeve të ndryshme të tyre mbi dauetin, tregojnë interesim për Sirën për arsye të ndryshme. Ata i kushtojnë rëndësi Sirës, me qëllim që të gjejnë bazë për zhvelimin e tyre dhe për atë në çfarë janë të interesuar grupet e tyre.

Brenda Sirës, është edhe ajo që nga ata s'mund të nxirren si dëshmi për shumë çështje të dauetit, e që mund të jenë

deduktim i saktë apo i gabuar. Kështu, në këtë kohë, është shfaqur një shkollë e madhe e të kuptuarit, e cila shkruan rreth Sirës dhe mësimëve e shembujve që duhet nxjerrë nga Sira dhe nga studimet e saj për shkolla të ndryshme të të kuptuarit të Sirës.

Shumë nga këta nuk i kushtojnë rëndësi autenticitetit brenda Sirës, por e bëjnë Sirën një shembull për atë çfarë duan nga dobitë e dauetit, qoftë e vërtetë apo e pavërtetë, qoftë nëse është verifikuar sipas dijes islamike, fikhut dhe akidesë, apo jo. Për këtë arsye, shumë libra kërkojnë të kuptojnë Sirën sipas kësaj forme të të kuptuarit, dhe kjo shkollë mund të quhet "Shkolla e dauetit bashkëkohor për kuptimin e Sirës".

- Shkolla e pestë e të kuptuarit

Shkolla e pestë e të kuptuarit është ajo e rrëfenjave dhe e tregimeve, pasi shumë nga ata që kanë paraprirë si edhe ata të kohës sonë e kuptojnë Sirën si një rrëfenjë apo tregim. Madje, ata mund ta kuptojnë një faqe apo dy si një shpjegim apo një udhëtim letrar dhe e bëjnë atë dhjetë apo njëzet faqe për të dalë nga tema. Kështu, ata e shndërruan Sirën në rrëfenja e tregime të ndryshme, me qëllim që të jetë një këshillë për këdo që e lexon atë.

Mirëpo, shumë mbrojtës të Islamit kanë kundërshtuar masën e madhe të rrëfenjave, tregimeve e fabulave, dhe një pjesë e kësaj edhe është përkthyer. Ata e kundërshtuan këtë duke transmetuar Sirën nëpërmjet rrëfenjave dhe transmetimeve të vërteta. S'ka dyshim që

në këtë ka dobi, por kjo, po ashtu, ka aspektet e saja negative, edhe pse kjo përdoret si formë e të kuptuarit për disa nga nxënësit e dijes, të cilët i njohin kufijtë e asaj që Allahu i shpalli të dërguarit të Tij. Ata e shkruan atë sipas formës së rrëfenjave dhe tregimeve, në çka edhe s'ka ndonjë problem. Mirëpo, në këtë duhet të ketë besueshmëri dhe duhet të jetë e verifikuar, meqë brenda saj ka shumë dobi si për të rinjtë, ashtu edhe për të rriturit.

Këto janë të gjitha shkollat e kaluara dhe të pranishme të mendimit në kuptimin e Sirës.

Nëse shikojmë në Sirën, pra, në atë çfarë është shkruar në librat e Sirës nga transmetimet e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], gjejmë se Sira nxjerr përfundime për disa ngjarje, për të cilat dijetarët e selefëve dhe verifikuesit nga dijetarët pas tyre i kanë konsideruar si konkluzione jo të shëndosha dhe mund të jenë të pavlefshme, dhe që, në fakt, mund të jenë edhe shirk. Kjo na shpie te shpjegimi i llojit që mund të quhet "Llojet e deduktimeve të gabuara nga ngjarjet e Sirës". Kjo është theksuar nga disa prej hulumtuesve, të cilët kanë bërë bashkë deduktimet e gabuara në dritën e asaj që është transmetuar në Sirë lidhur me çështjet që nuk janë vërtetuar mbi dijen e shëndoshë dhe e cila nuk është mbështetur nga Imamët apo dijetarët.

Kështu, nga shembulli i këtyre çështjeve është se muslimanët, gjatë betejës së Jemames, përdorën emrin "Muhamed" si simbol. Kjo është përmendur nga et-

Taberi dhe nga Ibn Kethir në *el-Bidajeh ue'n-Nihaje* dhe në punimet e ngjashme me këto. Ata kanë thënë se kjo tregon për lejimin e kërimit të ndihmës nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] pas vdekjes së tij, meqë domethënia e "Muhamed" është "O Muhamed [Ja Muhamed!]", pra, një lutje drejtuar atij [salallahu alejhi ue selam].

S'ka dyshim që nxjerrja e vendimeve lidhur me akidenë, madje mbi çështjet që paraqesin thelbin e teuhidit, origjina e së cilës është kërkimi i ndihmës vetëm nga Allahu, siç është konkluzioni se kërkimi i ndihmës nga pejgamberi është i lejueshëm, shpërfill shumë nga tekstet e Kur'anit dhe Sunetit që kanë transmetime të shumëfishta, gjuhësisht dhe në domethënie. Kjo shpërfill të gjitha këto tekste autentike, për shkak të një transmetimi nga librat e Sirës. Dhe kjo përdoret si dëshmi nga disa të devijuar dhe nga disa thirrës bidatçinj.

Me siguri, kjo është një rezultat nga të menduarit se gjithçka që përmendet në Sirë të sahabëve [radi Allahu anhum], së brendshmi është autentike. Kjo është gabim, sepse ka gjëra të pavërteta që u janë atribuuar atyre dhe që, në fakt, janë gabime në teuhid, gabime në akide dhe gabime në Sunet, siç është shembulli që e përmendëm më herët.

Kështu, nëse shikojmë në *Tarikh* të Taberit, ku gjërat janë përmendur me zinxhirin e tyre të transmetimit, do të gjejmë se zinxhiri i transmetimit i një rrëfenje të

përmendur, përmban atë që është gënjeshtar [*kedhab*], i panjohur [*mexhhul*] dhe i dobët [*da'if*]. Dhe kjo mjafton që një tregim apo një transmetim i tillë të konsiderohet i pavlefshëm.

Ndaj, ai që e njeh fenë e të dërguarit [salallahu alejhi ue selam] e zhvlerëson një rrëfenjë të tillë, edhe pa shikuar fare në zinxhirin e transmetimit [*isnad*], sepse sahabët nuk kanë kërkuar ndihmë duke lutur dikë tjetër veç Zotit të tyre, të lavdishmit e më të lartit.

Domethënë, ata nuk kanë kërkuar ndihmë nga ai që s'është i aftë t'u ndihmojë - dhe ata janë më të mirët nga umeti -, dhe as nuk kanë kërkuar ndihmë duke iu lutur pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] pas vdekjes së tij.

Ky është një shembull se si mund të nxirren përfundime të gabuara lidhur me akidenë nga disa gjëra që janë përmendur në librat e Sirës, në librat e ekspeditave ushtarake dhe në librat e sahabëve [radi Allahu anhum]. Po ashtu, nga gabimet që kanë të bëjnë më gjërat e përmendura në Sirë, është edhe përhapja e haditheve të dobëta, të cilat nuk janë transmetuar besnikërisht nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] dhe, madje, mund të jenë hadithe të refuzuara dhe të pavlefshme.

Tashmë jua kam përmendur thënien e el-Hafidh el-Iraki: "Studenti duhet të dijë se Sira përbëhet nga ajo që është e vërtetë dhe nga ajo që nuk pranohet". Pra, brenda Sirës, është edhe ajo që është e papranueshme dhe e refuzuar, për çka dijetarët janë të vetëdijshëm. Nga kjo,

për shembull, janë shumë rrëfenja rreth priftit Behira. Origjina e rrëfenjës është e shëndoshë, por sa i përket zinxhirit të transmetimit dhe tregimit të asaj që gjendet në Sirë, shpjegimet shtesë nuk janë verifikuar dhe janë bartur pa zinxhirë të transmetimit.

Origjina e rrëfenjës është e shëndoshë, dhe në shumë ligjërata disa thirrës, predikues e njerëz që mbajnë hutbe, thonë që kjo është autentike, gjë që, në fakt, nuk është tërësisht autentike. Disa nga armiqtë e Islamit nga orientalistët dhe të tjerët mbështeten në ngjarjen e Behires dhe kështu nxjerrin përfundimin se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka marrë goxha dije nga prifti Behire dhe, më pas, ua ka përmendur sahabëve atë që ka mësuar, gjë që është e pasaktë dhe e gabuar.

Një shembull i kësaj është rasti kur një njeri e përmend qëllimin për ta vrarë pejgamberin [salallahu alejhi ue selam], që është një transmetim i cilësuar si i dobët nga një numër dijetarësh. Gabimi i marrjes së haditheve të Sirës është vënë në pah nga dijetarët si el-Alame el-Albani në librin e tij *ed-Difa'en el-Hadith un-Nebeuij ue's-Sirë*. Ky është një libër i mirë, që përmend shumë gjëra të përmendura në Sirë e që nuk janë ngjarje të vërteta. Ky libër, po ashtu, sfidon el-Butin dhe gjërat që gjenden në *Fikh us-Sirë*. Në të, gjendet edhe ajo që ai [Imam Albani] i ka shtuar *Fikh us-Sirë* të el-Ghazalit të kësaj kohe, ku ai ka parashtruar, ka nxjerr vendime dhe ka kontrolluar shumë hadithe. Të tjerë veç tij [dmth Imam Albani] nga të rinjtë dhe nxënësit e dijes kanë shkruar libra që verifikojnë e kontrollojnë hadithet që gjenden në Sirë.

Qëllimi i tërë kësaj është të tërhiqet vëmendja në faktin se hadithet që janë në Sirë, mund të jenë të vërteta dhe, nëse dijetarët shqyrtojnë këto hadithe, atëherë i shqyrtojnë që të gjitha. Por, nëse kjo bëhet për shkak të përpjekjes për të nxjerrë vendime apo vërejtje, atëherë dijetarët nuk e dëshirojnë këtë, por ata diskutojnë rreth asaj çfarë kanë shënuar dijetarët më të shquar lidhur me hadithet e këtilla.

Po ashtu, ka lloje çështjesh të lidhura për fikhun, të cilat janë të bazuara në ngjarjet e përmendura në Sirë, ndonëse ngjarjet e Sirës nuk janë në vetvete dëshmi për çështjet e fikhut, derisa të jenë verifikuar ose nëpërmjet Kur'anit, ose nëpërmjet asaj që është verifikuar në Sunet apo është përmendur nga sahabët në komentimet e tyre rreth Kur'anit dhe shpjegimet e tyre të Sunetit lidhur me ato ngjarje.

Për këtë arsye, gjejmë se shumë persona marrin disa ngjarje nga Sira, me qëllim të nxjerrjes së vendimeve prej tyre, ndonëse, në fakt, këto rregulla që ata i nxjerrin janë të gabuara, meqë dëshmitë për to s'janë të vërteta për t'u marrë si dëshmi. Pra, ajo mund të jetë e dobët, e pacaktuar, e pavlefshme dhe kështu me radhë.

Ibn Kajjim [rahimehullah] i ka kushtuar mjaft rëndësi kësaj në librin e tij *Za'd el-Me'ad*, ku përmend Sirën e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] dhe me mjaft kujdes shqyrtoi ngjarje të caktuara të përmendura në Sirë, për të cilat thuhet se kanë ndodhur në Mekë apo gjatë ekspeditave ushtarake. Ai qartësoi transmetimet e

vërteta që kanë të bëjnë me fikh dhe me dobitë e fikhut që mund të nxirren. Dhe ky libër është bërë pikërisht për këtë arsye.

Ndër gabimet e studimit të Sirës, të cilin e bëjnë bidatçinjtë dhe të çinteresuarit për dijen – ndonëse identifikohen me dauet -, është se çështjet e dauetit i mbështesin në Sirë. Si pasojë, ata nuk shikojnë në çfarë gjendet në tekstin apo në atë çfarë kanë thënë dijetarët lidhur me to. Për shembull, disa prej tyre nxjerrin vendime nga ngjarja e Sa'd ibn ebi Uekkas [radi Allahu anhu], kur ai hedh një gur që godet në fytyrë të një idhujtari në Mekë, duke e përdorur këtë si dëshmi për operacione të vrasjeve politike [atentate] dhe, po ashtu, e marrin këtë si dëshmi në kërkimin e tyre për lejimin e kompleteve vrasëse.

S'ka dyshim që kjo s'është metodologjia e saktë e dijes, ku ngjarjet e Sirës merren si bazë dijeje. Meqenëse për ajo [metoda e saktë] nënkupton marrjen e asaj që është e vërtetë nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] apo që është transmetuar besnikërisht nga sahabët dhe vendosur nga pejgamberi gjatë jetës së tij.

Një tjetër shembull është ajo çfarë kanë përmendur disa se rasti kur disa të rinj u mbledhën në xhaminë e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] për të dëgjuar opinionin e tij rreth betejës së Bedrit, është dëshmi për lejimin e inskenimit të seancave brenda xhamive dhe për demonstrata. Me siguri që kjo shkon kundër metodologjisë së saktë islamike dhe është thjesht një

shmangie nga vendosja e një dëshmie mes adhuruesit dhe Zotit të tij.

Një tjetër shembull është edhe ajo që gjendet në disa libra të Sirës lidhur me fshehtësinë mes sahabëve, të cilën disa e përdorin për të dëshmuar fshehtësinë në bërjen e dauetit dhe për atë se kjo fshehtësi është baza e dauetit dhe e organizimit të dauetit. Nëse kjo shqyrtohet me dije të saktë, me qëndrime dijetarësh dhe me dijetarët që mund të verifikojnë këtë, do të dalë në pah se kjo [fshehtësi mes sahabëve] s'është dëshmi për një metodë të tillë daueti, sepse fshehtësia në një çështje nuk është nënkupton fshehtësi në çdo gjë. Shpjegimi i kësaj është i mirënjohur në qëndrimet e dijetarëve, si Ibn el-Kajjim dhe të tjerët.

Po ashtu, nga çështjet që kanë të bëjnë me dauetin e që janë bazuar në librat e Sirës, është se disa grupime shpjegojnë se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka bërë dauet në Mekë për trembëdhjetë vjet, çka tregon se, sipas tyre, daueti duhet të bëhet në fshehtësi, si në periudhën Mekase, së bashku me të gjitha rregullat e asaj periudhe, dhe se daueti duhet të bëhet për trembëdhjetë vjet. Këtë, në të vërtetë, disa grupe edhe kanë nisur ta zbatojnë në disa vende islamike. Kështu, ata e ndanë dauetin në periudhën Mekase dhe në atë Medinase. Kur kjo ide u rrënjos tek ata dhe, si pasojë, u zhvillua grupi përgjegjës, dhe kur kaluan trembëdhjetë vjet pa fituar ata autoritet, thanë: "Autoriteti u arrit nga pejgamberi pas trembëdhjetë vjetëve, sepse ai ishte el-Mustafa. Nëse nuk arrijmë autoritet, do të përsërisim trembëdhjetë vjetshin.

Nëse prapë nuk arrijmë autoritet, prapë do të përsërisim trembëdhjetë vjetshin"[!!] Kjo dëshmon për devijimin në nxjerrjen e vendimeve, çka është evidente për këdo që ka intelekt, lere më ata që identifikohen me dijen islamike!

Njëloj, disa prej tyre kanë nxjerr nga Sira faza të dauetit dhe e bënë shoqërinë në të cilën jetojnë të njëjtën si atë të Mekës gjatë kohës së pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], duke bërë kështu njerëzit të ndjehen të izoluar, siç bëjnë disa grupe ekstreme. Dhe, po ashtu, i konsiderojnë njerëzit idhujtarë apo se kanë ngecur në çështjet e tyre, si *Xhema'at ut-Teuekkuf ue't-Tebejjun* dhe të ngjashmit me ta. Ky është gabim i madh. Ata bënë një sërë deduktimesh [nxorën vendime], por thjesht vetëm gjetja dhe mbajtja për një deduktim nuk është kriter, por kriter është nëse dëshmia e vërtetë dhe nëse deduktimi është i shëndoshë. Sa i përket nxjerrjes së vendimeve të gabuara, kjo, madje, mund të shpie në mosbesim ndaj ligjit hyjnor. Për shembull, disa thonë se alkooli s'është i ndaluar në ligjin hyjnor, sepse Allahu nuk ka thënë se është haram, por Ai vetëm ka thënë:

« Shmanguni prej tij [alkoolit], me qëllim që të jeni të suksesshëm » [el-Ma'ideh, 90]

... dhe se kjo paraqet një paralajmërim, jo një ndalim. Ndaj, studenti i Sirës duhet t'ua referojë dijetarëve atë me të cilën ndeshet.

Nëse personi s'është një nxënës dijeje apo një dijetar që mund të vlerësojë se a është i saktë konkluzioni apo jo -

qoftë kjo kur ka të bëjë me çështje të akides, me çështje të Sunetit dhe bidatit, me çështje që kanë të bëjnë me hadithet e dobëta dhe të vërteta, apo çështje që kanë të bëjnë me fikhun dhe rregullat, si dhe çështje të dauetit -, a pajtohet dija islamike me deduktimin e tij, apo jo? Meqë ne s'do të vendosim fenë apo të mbërrijmë forcë në dauet, përveç duke pastruar menhexhin [metodologjinë] tonë, kur nxjerrim apo deduktojmë dëshmitë. Pra, nëse në nxjerrjen dhe deduktimin e dëshmimeve kemi një menhexh të qartë, shoqëria jonë, thirrësit, njerëzit që identifikohen me Islam dhe i tërë umeti do të jetë i fortë, sepse burimet dhe qëndrimet e dijetarëve që bëjnë verifikimin, do të bashkohen në parimet e ligjit hyjnor dhe parimet e nxjerrjes së vendimeve në akide, rregulla, mësimet dhe shembuj.

Nëse e kuptoni këtë, gjejmë se disa nga sekularistët që kundërshtojnë ligjin hyjnor dhe fenë, si dhe socialistët e të ngjashmit me ta, gjejnë brenda Sirës atë që mund të nxirret për mënyrat/rrugët e tyre. Socialistët thonë se socializmi i tyre mund të nxirret nga Sira, siç është shpërndarja e pasurisë të të gjithë, madje, edhe shpërndarja e grave të të gjithë[!], me anë të përdorimit të rrëfenjave të pejgamberit rreth vëllazërimit mes muhaxhirinëve dhe ensarëve. Sepse një person trashëgonte nga vëllai i tij – jo vëllai nga gjaku, por vëllai në fe –, me të cilin e kishte vëllazëruar pejgamberi [salallahu alejhi ue selam]. Pra, ata trashëguan nga njëritjetri, derisa u shpall thënia e Allahut:

« Lidhja e gjakut [farefisi] është më e afërt [sa i përket trashëgimisë] në vendimin e caktuar nga Allahu » [el-Enfal, 75]

Kështu, lidhur me pasurinë, ata e përdorin këtë si dëshmi për socializmin e tyre se [kinse] kjo është baza e socializmit për të cilin ka thirrur pejgamberi [salallahu alejhi ue selam]. Disa prej tyre përdorin si dëshmi praninë e grave në përkujdesje [ndaj të plagosurve] gjatë luftimeve si bazë për përzierje mes gjinive. Ajo çfarë kanë për qëllim ata [socialistët] është përzierja e ndaluar dhe se nuk ka kurrfarë problemi që një grua të punojë së bashku me një burrë brenda çdo fushe, qoftë në atë mjekësore apo në ndonjë tjetër. Kështu, brenda disa ngjarjeve, ata gjetën një shteg për të kjo, duke marrë ngjarje të caktuara dhe duke i shqyrtuar ato, duke u bërë fakihe [juristë!], edhe nëse personi s'ka çfarëdo qoftë autoriteti në Islam!

Ndaj, Sira përbëhet prej rrëfenjave, informatave e tregimeve dhe, si pasojë, nxjerrja e vendimeve s'mund të formohet duke pranuar në tërësi atë që gjendet në Sirë, derisa ajo dëshmi të jetë verifikuar si autentike dhe pastaj të shihet nga aspekti i deduktimit. Nëse kemi mbërri këtë fazë, atëherë ka pjesë të caktuara që unë do t'i lë anash, për shkak të kohës, dhe kjo çështje, në fakt, është shumë e rëndësishme dhe kërkon qartësim të mëtutjeshëm. Mirëpo, do ta përfundojmë duke përmendur temën e kësaj ligjërate dhe konkluzionin rreth asaj që është përmendur më herët, së bashku me të kuptuarit e parimeve të cilat janë të domosdoshme për ne t'i

mësojmë për miratimin e Sirës si edhe për deduktim e të kuptuar.

1. Parimi i parë është të organizohet fortësia e burimeve në tri grada. Grada e parë është Kur'ani i lavdishëm, kështu që çfarëdo që tregon Kur'ani, ajo zë vend para të gjithave.

Pastaj Suneti i pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], që sqaron atë çfarë gjendet në Kur'an. Suneti është ajo që është verifikuar se është bërë nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam], qoftë nëpërmjet transmetimeve të hadithit *ehad* [të vetëm] apo nëpërmjet transmetimeve të hadithit *muteuatir* [të shumëfishtë], qoftë me zinxhirë të transmetimit që janë sahi ose hasen. Kështu, nëse një hadith është verifikuar, atëherë mund të merret në Sirë dhe ka përparësi para çdo gjëje [pas Kur'anit].

Ajo që pason është marrja nga shpjegimet e dijetarëve - ndër sahabët dhe ata pas tyre - rreth ajeteve të Kur'anit apo haditheve nga Suneti. Sepse ata kryesisht e shpjegojnë Kur'anin bazuar në dijen e tyre rreth Sunetit të el-Mustafasë [salallahu alejhi ue selam].

Grada e tretë është ajo që ka arritur në librat e Sirës. Nëse në librat e Sirës gjejmë diçka që nuk kundërshton Librin dhe Sunetin, mund ta marrim atë, meqë kjo nuk bie në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunetin, posaçërisht nëse dijetarët kanë rënë dakord rreth verifikimit të tij. Kështu, nuk është e gabuar për në të pranojmë atë, ashtu siç e kanë përmendur disa dijetarë, dhe s'ka dyshim që Sira

mund të verifikohet edhe më fort nga rrëfenjat e Bijve të Israilit meqë pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka bërë lëshim në marrjen e rrëfenjave nga Bijtë e Israilit, duke thënë: "... transmetoni nga Bijtë e Israilit. S'ka problem në këtë ..."

Pra, ne nuk i pranojmë rrëfenjat e tyre e as nuk i shpërfillim. Sa i përket asaj që ka të bëjë me Sirën dhe që nuk e kundërshton tekstin e Kur'anit apo të Sunetit, atëherë s'ka problem në pranimin e transmetimeve të tilla. Sepse dijetarët kanë përmendur se ato mund të merren për sa kohë që nuk bien në kundërshtim me atë që gjendet në Libër dhe në Sunet në parime dhe në degët e Sirës. Ky është parimi i parë.

2. Parimi i dytë në të kuptuarit, të lexuarit dhe vlerësimin e Sirës është se nga Sira mund të përftohen dobi që kanë të bëjnë me dauetin, me imanin dhe me dijen. Kështu, është obligim për këdo që e lexon Sirën apo përmend atë që gjendet në të që t'i kushtojë vëmendje të posaçme pranisë së të gjitha çështjeve që e kanë vendin e tyre. Pra, nëse një rrëfenjë thekson ndonjë betejë apo atë çfarë i ka ndodhur pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] dhe sahabëve të tij, qëllimi i saj është të forcojë imanin në zemra, dashurinë ndaj pejgamberit si edhe lidhjen e tyre me Sirën e el-Mustafasë [salallahu alejhi ue selam]. Në këtë rast, të pranosh Sirën, për shkak të kësaj, është në përputhje me parimin e parë që pamë më herët.

Pastaj, nëse në Sirë gjendet diçka që kundërshton ndonjë vendim të dijetarëve lidhur me teuhidin, tefsirin e Kur'anit, Sunetin, dauetin, vendimet dhe rregullat e fikhut, atëherë duhet të bëhet sqarim, në mënyrë që të mos formulohet ndonjë rrëfenjë që ka çështje të refuzuara lidhur me ligjin hyjnor.

Aspekti i dytë i këtij parimi është interesimi për çështjet e fikhut dhe të dijes, duke këqyrur Sirën për dijen që mund të nxirret nga ajo. Domethënë, kur një nxënës dijeje vlerëson Sirën jo vetëm si një rrëfenjë apo tregim, por e sheh atë nga aspekti i përfitimit të dobive lidhur me rregullat e fikhut.

Merrni për shembull tregimin e betejës së Hudejbijes apo, në fakt, pushtimin e Hudejbijes, prej të cilës Ibn Kajjim përftoi një numër dobish që kanë të bëjnë me fikhun, siç janë aktet e adhurimit, bashkëveprimet shoqërore, madje edhe çështje që kanë të bëjnë me shtetin Islamik dhe njerëzit autoritar, mbretërimin dhe gjendjet që e fascinuan atë. Kjo, pa dyshim, është një pikëpamje madhështore e fikhut, i cili është i detyrueshëm për një nxënës dijeje gjatë analizës.

3. Parimi i tretë për vlerësimin e Sirës është se Sira e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] bën dallim mes teuhidit dhe shirkut. Kështu, Sira e tij s'është thjesht një Sirë e një lideri të një partie politike apo e ndokujt që ka kërkuar pushtet apo diçka të këtij lloji, por ajo paraqet një çështje madhore, që është çështja më madhore që mund të kërkohet – teuhidi i Allahut.

Për këtë shkak, mund të vëresh se dijetarët verifikues, të cilët i kushtojnë rëndësi çështjes së teuhidit, si Ibn Tejmije, Ibn Kajjim, Imam Muhamed ibn AbdulUehab dhe të tjerë pas tij, shikuan në Sirë dhe në ngjarjet që ndodhën në të dhe e identifikuan këtë me betejën mes teuhidit dhe shirkut. Kështu, kushdo që shikon në librin e Sirës së Abdilahut, birit të imamit [rahimehullah], do të shohë rëndësinë e tyre lidhur me dobitë e betejës mes teuhidit dhe shirkut. Ky është një deduktim i saktë, sepse bazohet në një deduktim që ka të bëjë me zbatim, gjë që ishte edhe realiteti i pejgamberit dhe i shoqëruesve të tij. Njerëzit që këqyrin Sirën, janë pajtuar rreth kësaj betejë mes thirrësit për te Allahu - apo udhëheqësit të thirrësve, apo udhëheqësit të të dërguarve [salallahu alejhi ue selam] - dhe mes idhujtarëve, mosbesimtarëve që janë kokëfortë ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij. Allahu i ka thënë të dërguarit të Tij:

« Thuaj: 'Kjo është rruga ime. Ju thërras për te Allahu me urtësi, unë dhe ata që më ndjekin. I lartësuar është Allahu! Dhe unë nuk jam nga ata që i shoqërojnë ortakë Atij [në adhurim]' » [Jusuf, 108]

Allahu sqaron se synimi i rrëfenjave është të parashtrohen shembuj dhe mësim. Allahu i lartësuar ka thënë:

« Vërtet, në rrëfenjat e tyre ka mësim për njerëzit që kuptojnë. Ky [Kur'ani] s'është thënie e falsifikuar ... » [Jusuf, 111]

Kjo është e mirënjohur te dijetarët.

4. Parimi i katërt është për dijetarët, për nxënësit e dijes dhe për thirrësit, me qëllim që të mos i qasen Sirës pa njohuri. Pra, s'duhet të mendohet se Sirës mund t'i shtohet apo të hiqet diçka. Dhe, ndoshta, keni dëgjuar për ata që përpilojnë tregime, qoftë në libra apo në ligjëratë, ku autori apo folësi përmend ngjarje nga Sira dhe pastaj i shton analizën e vet, duke menduar se Sira nuk përmban tjetër veçse rrëfenja të cilave bën t'u shtohen gjëra. Kjo është e gabuar dhe, në të vërtetë, e pavlefshme.

Ndaj, Sira është Sira e el-Mustafasë, e cila nuk pranon shtojca të ngjarjeve që ndodhën në të. Nëse dikush do të shpjegojë atë që është verifikuar, atëherë kjo është e mirë për sqarim dhe një komentim për njerëzit, që të marrin shembuj dhe dobi. Sa i përket shtimit në rrëfenja, kjo është e gabuar dhe përbën një lloj të të folurit rreth Allahut pa dije, madje edhe lloj gënjeshtre ndaj pejgamberit [salallahu alejhi ue selam].

Kështu, për shembull, dikush mund të mos e përmend si duhet hadithin rreth disa betejave. Ata, po ashtu, përmendin disa hadithe lidhur me disa ngjarje që zunë vend në Mekë me sahabët e pejgamberit dhe zotimin për besnikëri në Akabe, si dhe migrimin e sahabëve në Etiopi dhe ngjarje të ngjashme, të cilat nuk janë me vend aspak dhe janë shtojca për tregime të rrejshme.

Kjo nuk duhet të veprohet assesi, meqë çështja është tepër e rëndë sa i përket gënjimit ndaj Sunetit të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Shembulli më i shquar i këtij paralajmërimi është thënia e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], që është një hadith muteuatir:

"Kushdo që gënjen qëllimisht ndaj meje, le të përgatitet për një ndenjes në Zjarr".

5. Parimi i fundit është maturia në kritikën ndaj asaj çfarë kanë theksuar dijetarët rreth Sirës. Kjo Sirë ka një pozitë dhe shumë përpiqen t'i mashtrojnë dijetarët apo t'i dënojnë ata me atë që është e pavend dhe në këtë nxitohen. Rrëfenjat e Sirës dhe verifikimi i tyre, si dhe ixhtihadi në komentimin e qëllimeve të saj janë të shumta.

Kështu, nëse një rrëfenjë apo një biografi e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] a e sahabëve nuk bie ndesh me tekstin e Librit dhe të Sunetit, apo s'është e pavlefshme dhe ka të bëjë me akide apo me ligjin hyjnor dhe Sunetin, atëherë qëllimi i saj pranohet nga dijetarët. Pra, nuk mundet dikush të na vjen e të thotë se ka transmetuar nga Sira atë që s'është verifikuar, që mund të jetë një hadith i dobët në Sirë, dhe të ngjashmet më këto.

Ndaj, baza tek ata është ajo çfarë tashmë jua përmenda lidhur me përhapjen e Sirës, për sa kohë që nuk është transmetuar nga ajo që është e pavlefshme dhe e refuzuar. Kjo është një bazë madhështore, nga rëndësia e së cilës s'mund të iket, sepse kritika e njerëzve për dije

apo orvatja për t'iu qasur atyre pa dëshmi të qarta është e papranueshme dhe, madje, mund të jetë shkak për çështje të dënueshme.

Ka edhe disa të tjera çështje, por kësaj here po e lëmë me kaq.

E lus Allahun lavdishëm, më të lartin, të na bëjë dobi me Sirë të peygamberit [salallahu alejhi ue selam], të na japë dobi në atë që e mësojmë, dhe të na e shtojë dijen, punën e udhëzimin. Dhe e lus Allahun të na e ndreq fenë tonë, e cila e mbron çështjen tonë, dhe të na i ndreq punët e kësaj bote dhe fundin tonë. Dhe e lus Allahun t'i korrigjojë përgjegjësit e punëve tona, t'i udhëzojë ata dhe t'i largojë nga njerëzit e çrregullimit e të korrupsionit. E lus Allahun të na bëjë nga ata që bashkëpunojnë me ta në bindje ndaj Allahut dhe në drejtësi, jo nga ata që bashkëpunojnë në mëkat dhe armiqësi. Dhe e lus Allahun për mua, për ju dhe për çdo musliman, për një fund të drejtë, me një lumturi të përhershme. Dhe lutjet, paqja dhe bekimet qofshin mbi peygamberin Muhamed.

- Pyetje-përgjigje

Pyetje: Disa dijetarë përmendin se përpjekjet e njerëzve të drejtë në devotshmërinë e tyre, si namazi etj., bien në kundërshtim me atë çfarë bënte peygamberi [salallahu alejhi ue selam]. Çfarë qëndrimi duhet të marrim në këso rastesh?

Përgjigje: I tërë lavdi i takon Allahut. Veprimet e dijetarëve nuk janë dëshmi mbi ligjin hyjnor, por dëshmi është vetëm çfarë tregon Libri dhe Suneti, si dhe veprimet e sahabëve [*riduanullahi alejhim*], nëse janë në pajtim me këtë. Ajo çfarë përmendet në biografitë e disa dijetarëve, duhet të ndahet në kategori: ajo që mund të interpretohet, siç është rasti kur disa prej tyre qëndronin tërë natën në namaz, gjë që kundërshton Sunetin, apo se disa prej tyre e lexonin tërë Kur'anin për çdo ditë, siç transmetohet nga Imam esh- Shafi'i [*rahimehullah*] se ai, gjatë ramazanit, e lexonte tërë Kur'anin gjashtëdhjetë herë.

Pastaj, ajo që është transmetuar nga disa prej tyre se Uthmani [*radi Allahu anhu*] e kryente tërë Kur'anin në një rekat afër Kabës, gjë që është e vërtetë, dhe gjëra të ngjashme. Nga dijetarët këto janë interpretuar të jenë ndër gjërat që disa dijetarë nuk i vepronin vazhdimisht, por vetëm nganjëherë. Sa i përket plotësimit të Kur'anit, dijetarët e kanë vlerësuar këtë në dritën e hadithit ku pejgamberi ka thënë: "... nuk duhet të plotësohet për më pak se tre ditë". Kjo është për këdo që ka mundësi. Kurse, sa i përket shfrytëzimit të një kohe të vlefshme si ramazani, ku personi dëshiron ta kryejë tërë Kur'anin në një kohë të shkurtër, atëherë selefët e kanë bërë këtë, prandaj është e lejueshme, dhe hadithi kuptohet nga ky kënd. Njëlloj, sa i përket çështjeve të namazit dhe faljes së namazit gjatë tërë natës, nëse kjo bëhet rregull dhe praktikë e përgjithshme, kjo e kundërshton Sunetin. Sa i përket atij që ka zemër të forcuar dhe lutet/falet, dhe bën njërën nga këto gjëra vetëm nganjëherë, atëherë ky është

interpretim i tij dhe Suneti është gjyqtar vendimtar mbi këtë veprim të tijin.

Disa tregime rreth dijetarëve apo rreth të devotshmëve në vetvete mund të jenë të pavlefshme dhe të transmetuara në mënyrë të pasaktë. Për shembull, ajo që është transmetuar nga Ahmed si tregim mbi asketizmin [zuhd] e tij, është e shpikur, dhe të tilla janë edhe disa tregime rreth Imam Shafi'i, të cilat i kanë vënë në pah dijetarët.

Po ashtu, disa gjëra që janë transmetuar rreth njerëzve të drejtë janë të pavlefshme në dritën e ligjit hyjnor dhe s'është e lejueshme të pranohen, edhe nëse njerëzit këshillojnë me to. Si të tilla, këto tregime japin një imazh dhe një shembull negativ për t'u pasuar. Për shembull, ditë e natë filani hante vetëm rrepkë, duke thënë: "Për dy ditë nuk gjeta gjë tjetër veç rrepkave", për shkak të interesimit të madh në kërkimin e dijes. Për pesë ditë, ai mbeti pa ngrënë gjë, pasi bleu peshk por nuk e hëngri, për shkak se ishte i zënë me kërkim të dijes! Apo se filani donte ta lironte veten nga e keqja dhe zvarritej për tokë, me qëllim që ta mësonte veten për intensitetin e dënimit në xhehenem!!

Shembujt e këtyre tregimeve janë të pavlefshme dhe nuk bën t'u tregohen njerëzve, sepse paraqesin një imazh dhe një shembull negativ. Njerëzit kanë nevojë për Sunetin e el-Mustafasë [salallahu alejhi ue selam], Sirën e sahabëve [radi Allahu anhum].

Pejgamberi ka thënë: "Prej jush më së shumti unë i frikohem Allahut. Megjithëkëtë, agjëroj dhe e ndërpres, falem gjatë natës dhe fle, dhe gjithashtu martohem më gra. Pra, kushdo që kundërshton Sunetin tim, s'është nga të mitë".

Përkryerja qëndron në udhëzimin e tij [salallahu alejhi ue selam], kështu që teprimi me tregime që e zbusin zemrën nga ajo që s'është e vërtetë në ligjin hyjnor, nuk është e lejueshme, meqë kjo sjell rezultate negative duke pasur mendime jo të mira rreth njerëzve që na kanë paraprirë apo duke gënjyer ndaj tyre.

Pyetje: Çfarë mendoni rreth librave të Sirës si *er-Rahik el-Mekhtum* [Nektari i Vulosur] dhe librit të Ebu Bekr el-Xheza'irij?

Përgjigje: Këto libra përmbajnë dobi. *er-Rahik el-Mekhtum* është libër i mirë dhe, po ashtu, edhe ai i Ebu Bekr el-Xheza'irij. Ka disa çështje që janë diskutuar nga dijetarët e Sirës, por megjithëkëtë janë më të dobishme sesa disa punime tjera, të cilat janë punuar kohëve të fundit.